



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 383/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me apelet e subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), me seli në Graçanicë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit dhe ndikimit tek rezultati final, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 08.11.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHEN** të pasafatshme apelet: Anr.383/2019, Anr.384/2019, Anr.385/2019, Anr.389/2019, Anr.390/2019, Anr.391/2019, Anr.403/2019, Anr.409/2019, Anr.412/2019, Anr.421/2019, Anr.422/2019, të gjitha të datës 07.11.2019, të paraqitura nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), me seli në Graçanicë, kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit dhe ndikimit tek rezultati final, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 07.11.2019, ka pranuar apelet: Anr.383/2019, Anr.384/2019, Anr.385/2019, Anr.389/2019, Anr.390/2019, Anr.391/2019, Anr.403/2019, Anr.409/2019, Anr.412/2019, Anr.421/2019, Anr.422/2019, nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), me seli në Graçanicë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), në të cilat pretendon se gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në ditën e votimit, nga ana e këtij subjekti politik janë vërejtur parregullësi të cilat kanë ndikuar në rezultatin final të zgjedhjeve. Sipas paraqitësit të ankesës këto parregullësi kanë të bëjnë me keqpërdorim të dispozitave ligjore të rregullave zgjedhore në qendrat votuese në komunat me shumicë serbe, duke ndikuar në vullnetin e votuesve, ashtu që persona të shëndoshë dhe të aftë për punë masivisht janë shpallur si persona me aftësi të kufizuara dhe janë shtyrë që të drejtën për të votuar ta realizojnë nën asistencën e antëtarëve të subjektit politik Srpske Listë, e

gjithë kjo për kontroll të votës; në Qendrën e Votimit në Mitrovicën Veriore, pas numërimit të të gjithë votuesve në gjithësej 27 Vendvotime në këtë komunë, të dhënat në publik lidhur me numrin e votuesve, me qëllim janë dhënë jo të sakta, ashtu që me rastin e mbylljes së VV-ve, të bëhen manipulime me proceverbalin; me pretendimin se në VV 2304/D01R, së paku një fletëvotim është i vulosur me vulë joadekuate të VV-së; në VV 2308D/01R, së paku pesë fletëvotime janë vulosur me vulë joadekuate të VV-së; në VV 2303D/03R, në kutinë e votave, së paku një fletëvotim është i vulosur me vulë joadekuate të VV-së; dhe si i tillë është klasifikuar si i pavlefshëm; në VV 2304D, në kutinë e votave, së paku shtatë fletëvotime janë vulosur me vulë joadekuate të VV-së, apeluasi ka kërkuar rinumërim të votave dhe verifikimin e validitetit të të gjitha vulave tek VV në fjalë; më tej paraqitësi i apeleve pretendon se në VV 3805X,3804B,3805B,3806B, është shkelur neni 91 i LZP-së, në atë mënyrë që është bërë votim i organizuar i disa grupacioneve nga persona të njëjtë në këto vendvotime; në QV 3703D Kllokot, Vrbovc.U QV 3703D Kllokot, Vrbovc, është lajmëruar mbajtja e kryetarit të komunës së Kllokotit më gjatë se 15 minuta, veprim ky me të cilin drejtpërdrejt ka ndikuar me pozitën e tij në vullnetin e votuesve; në VV 3601D Donja Budriga komuna Partesh, ditën e zgjedhjeve është bërë keqpërdorim i postit të anëtarit të vendvotimit, ashtu që për shkak të një incidenti në këtë vendvotim është ndërprerë votimi për dyzet minuta, sepse Nastiq Sinisha ka vërejtur keqpërdorim me regjistrin e votuesve, në të cilin qysh para votimit ishte i nënshkruar në listën zgjedhore, paraqitësi i apeleve në fjalë kërkon nga PZAP-i, që të marrë vendim për rinumërim në vendvotimet e përmendura, në komunat me shumicë serbe.

Paneli, në kuptim të nenit 3 par.8 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ankesat në fjalë vendosi t'i trajtojë si apelim, duke konsideruar se në këtë rast, trajtimi i tillë është më adekuat, ndërsa në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartëcekura dhe i trajton si një apel të evidentuar me Anr 383/2019, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve në aspektin subjektiv dhe atë përmbajtësor, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli, pasi që shqyrtoi afatshmërinë e apeleve, gjeti se :

### **Apelet janë të pasafatshme**

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit sipas nenit 119 par.1 të LZP-së, dhe nenit 5.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it. Në rastet konkrete qendra e votimit është mbyllur më datë 06.10.2019 në ora 19:00, ndërsa apelet Anr.383/2019, Anr.384/2019, Anr.385/2019, Anr.389/2019, Anr.390/2019, Anr.391/2019, Anr.403/2019, Anr.409/2019, Anr.412/2019, Anr.421/2019, Anr.422/2019, nga apeluasi janë paraqitur në PZAP me datë 07.11.2019, që do të thotë pas afatit të paraparë ligjor të përcaktuar me nenin 119 par.1 të LZP-së.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart e në kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr. 383/2019 më datë 08.11.2019

**Kryesues i Panelit**  
Rrustem Thaqi



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimet të këtij vendimi.